



MBËSHTETJE REFORMËS NË SHËNDETËSI



Raportimi i incidenteve spitalore, projekti që rrit cilësinë

Një mënyrë për të përmirësuar edhe më tepër shërbimin që u jepet pacientëve në sistemin shëndetësor në vend, është raportimi dhe dokumentimi i incidenteve që ndodhin në spitale

19

SPITALI I KORÇËS

Drejtori Papando:
Spitali po
ndërtohet me nivele
bashkëkohore



Guçi: Kontrolli i
vizitave, për një
shërbim më të mirë

20

VIZITAT

Spitali Lezhë
ngre sportele për
menaxhimin korrekt

21



TIRANË

Beqaj: Marrëdhënie
e re mes mjekëve
dhe qytetarëve

18



E
SHËNDETËSISË

Komuniteti dhe shëndetësia, Bardhi: Duhet më tepër informacion dobiprurës

Në takim mori fjalën edhe drejtoresha e gazetës "Shëndet Plus", Eglantina Bardhi. Mes të tjerash ajo ngriti problemin e mungesës së informacioneve edukuese dhe ndërgjegjësuere për popullatën në mediat vendase. "Asnjëra nga mediat nuk e ka përparësi informimin e popullatës lidhur me reformat dhe problematikat që mbart ky sektor", theksoi Bardhi, ndërsa vijoi se problem mbetet fakti i mosdedikimit të një gazetari për shëndetësinë, si dhe mungesës së trajnimeve për ta. "Në mediat vizive dhe të shkruara nuk ka asnjë gazetar që të mbulojë vetëm sektorin e shëndetësisë, por njëkohësisht mbulojnë edhe fu-

sha të tjera, si: sociale, arsim, mjedis etj. Kjo e vështirëson thellimin e njohurive të tyre në fushën e shëndetësisë", tha Bardhi. "Mungesa e trajnimeve dhe edukimit të gazetarëve ka sjellë mungesën e njohurive dhe aftësive për të raportuar në mënyrë sa më korrekte dhe me profesionalizëm". Gjithashtu ajo tha se në shumicën e institucioneve shëndetësore mungojnë strukturat e informimit. Specialistë të ndryshëm informojnë në mënyrë të ndryshme. P.sh.: në ISHP gazetarët edhe kur bëhet fjalë për raste epidemish marrin deklarata të ndryshme nga specialistë të ndry-

shëm. Për më tepër, sipas Bardhit, gazetarëve shpesh nuk iu hapen dyert e institucioneve për të marrë informacion në kohë reale.

Duke e cilësuar gazetën "Shëndet Plus" si e vetmja në vendin tonë që është tërësisht e përqendruar në sektorin e shëndetësisë, Bardhi tha se ajo ka si qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e popullatës për shëndetin dhe një stil jetese të shëndetshëm.

Gazeta ka bashkëpunuar edhe USAID-in për suplementin "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" duke pasqyruar kështu histori suksesi në spitalet ku po zhvillohet ky projekt.



USAID: Qytetarët, më shumë besim te mjekët se tek sistemi

Sistemi shëndetësor në Shqipëri ka ngecur në një rreth vicioz korrupsioni dhe shërbimi të dobët. Mungesa e standardeve të duhura të shërbimit, të infrastrukturës dhe gatishmërisë, i detyron qytetarët ta mbështesin këtë sistem duke përdorur ryshfete dhe zgjidhje informale të problemeve të tyre. Ky është imazhi që spitalet publike kanë në sytë e qytetarëve sot. Sipas një studimi të realizuar nga USAID në mars të vitit 2013 në tri qytete, Tiranë, Korçë dhe Lezhë, korrupsioni, shërbimi i dobët, mungesa

e higjienës, mungesa e medikamenteve dhe paafërsia janë çështjet më shqetësuese që raportohen nga komuniteti për spitalet publike. Të anketuarit raportojnë se kryejnë pagesa informale për të marrë shërbim shëndetësor dhe kujdes më cilësor. Por ata thonë se një arsye tjetër pse japin ryshfet ka të bëjë edhe me anashkalimin e sistemit burokratik, për të shmangur procedurat e gjata dhe të komplikuar. Të gjitha këto probleme kanë bërë që pjesa më e madhe e qytetarëve të kenë më shumë besim te spitalet private. Për këtë arsye është bërë matja e shkallës së besimit që komuniteti ka ndaj spitaleve publike dhe private, si dhe mjekëve në përgjithësi. Të anketuarve iu kërkua t'i vlerësonin këto institucione në një shkallë besimi nga 0-100, ku 0 nënkupton "aspak besim", 50 "as besim, as mosbesim" dhe 100 "besim total". Sipas të dhënave të prezantuara nga USAID, spitalet/klinikat publike janë vlerësuar me 47 pikë në shkallën e besimit, duke treguar kështu se të anketuarit kanë më shumë mosbesim sesa besim ndaj tyre. "Niveli i besimit ndaj spitaleve/klinikave private është relativisht më i lartë, me një rezultat prej 64 pikësh në shkallën e besimit. Të anketuarit shfaqin një nivel më të lartë besimi ndaj mjekëve në përgjithësi, krahasuar me spitalet/klinikat publike. Mjekët kanë një rezultat prej 62 pikësh në shkallën e besimit", thuhet në raportin e USAID-it. Sipas këtij studimi, të anketuarit në moshë të re, 18-39 vjeç, kanë një nivel relativisht më të ulët besimi ndaj spitaleve/klinikave private dhe mjekëve krahasuar me të anketuarit e moshës 40-60 vjeç. Mesatarisht ata e vlerësojnë nivelin e tyre të besimit ndaj spitaleve/klinikave publike dhe mjekëve përkatësisht me 38 pikë (krahasuar me 59 pikët e të anketuarve më të moshuar) dhe 56 pikë (krahasuar me 71 pikët e të anketuarve më të moshuar).

Në takimin e zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë morën pjesë ekspertë të projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi", financuar nga USAID dhe drejtues të institucioneve shëndetësore

Reforma në shëndetësi, marrëdhënie e re mes mjekëve dhe qytetarëve

Përfshirja e komunitetit në vendimarrjen për shërbimet shëndetësore dhe vënia e pacientit në qendër të kujdesit shëndetësor ishte tema e takimit të zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë. Në të morën pjesë ekspertë të projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi", të financuar nga USAID-i, drejtues të institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe administratës së spitaleve rajonale në vend, në lidhje me mësimet e nxjerra nga zbatimi i ndërhyrjeve të këtij projekti dhe mbështetjen e duhur që ndërhyrje të tilla të mund të funksionojnë me sukses edhe në spitalet e tjera publike. Ndërsa vlerësoi punën e USAID-it në spitalet e tre rretheve: Tiranë,

Korçë e Lezhë, ministri Ilir Beqaj theksoi nevojën për një qasje të re të spitaleve dhe institucioneve të kujdesit shëndetësor për sjelljen ndaj pacientit dhe përfshirjen e komunitetit, duke bërë thirrje për një marrëdhënie të re ndërmjet mjekut dhe pacientit. "Spitalet publike duhet të jenë jo vetëm vendet ku njerëzit mjekohen, por edhe qendra që mishërojnë solidaritetin e kulturën shoqërore", tha midis të tjerash ministri. "Dhe për këtë, ashtu siç sugjerojnë edhe gjetjet e projektit tuaj, nevojitet të rivendoset një marrëdhënie e re mes profesionistëve të shëndetit dhe qytetarëve: një marrëdhënie besimi dhe respekti reciprok. Kështu, ne besojmë se urat për lidhjen e

kësaj marrëdhënieje besimi dhe respekti reciprok mbështeten mbi shtyllat e bashkëbisedimit dhe nxjerrjes për përfshirjen në të, jo vetëm të gjeneratës së re të specialistëve të mirëfilltë të shëndetësisë dhe vlerave që ata mbartin, por edhe qytetarëve, të cilët janë pjesë e qenësishme përbërëse e recetës për rimëkëmbjen e sistemit, duke u bazuar tek vlerat e dialogut, përgjegjësisë dhe partneritetit të ndërsjellë".

Ministri i Shëndetësisë tha gjithashtu se besonte "se mësimet e nxjerra nga zbatimi i këtyre ndërhyrjeve, si projekti juaj 2013 në rrethet e Tiranës, Korçës dhe Lezhës, mund të funksionojnë me sukses edhe në spitalet e tjera publike!"



Një mënyrë për të përmirësuar edhe më tepër shërbimin që u jepet pacientëve në sistemin shëndetësor në vend, është raportimi dhe dokumentimi i incidenteve që ndodhin në spitale

Raportimi i incidenteve spitalore, projekti që ndihmon në rritjen e cilësisë

Aishe Thartori

Pjesë e projektit 5-vjeçar “Mbështetje e Reformës në Shëndetësi” që mbështetet nga USAID, është edhe nisma për raportimin e incidenteve spitalore. Raportimi i incidenteve është iniciuar tashmë prej një viti pranë Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”. Sipas mjekut obstetër-gjinekolog Maksim Gjoni, raportimi i incidenteve ka qenë një aktivitet i ri i llojit të tij, i cili nuk është realizuar dhe dokumentuar më parë në vendin tonë dhe si i tillë kërkon më shumë kohë. Sipas mjekut Gjoni, nisma ka për qëllim edhe përfshirjen e qendrave të tjera shëndetësore në vend.

Si ka vijuar procesi i raportimit të incidenteve spitalore?

Raportimi i incidenteve spitalore është një risi për sistemin tonë shëndetësor. Jo vetëm në SUOGJ, por në të gjithë sistemin nuk ka pasur deri më tani një raportim të incidenteve spitalore dhe për pasojë ne nuk kemi eksperiencë të trashëguar në këtë drejtim. Kështu për shembull, në rast se dikush

pësonte një aksident spitalor apo pësonte diçka gjatë periudhës së qëndrimit në spital, atëherë incidentet raportoheshin (merreshin dhe masa), por nuk dokumentoheshin, nuk ekzistonin në sistemin tonë. Për fat të mirë sot janë krijuar kushtet që çdo incident që raportohet, të dokumentohet.

Si realizohet raportimi i incidenteve spitalore?

Kemi përpiluar një rregullore në formën e një politike të raportimit të incidenteve e cila është funksionale jo vetëm për SUOGJ-in, por edhe për spitale të tjera të vendit. Pasi është përpiluar rregullojta, menjëherë i është komunikuar personelit. Investimi ynë më i madh është heqja e ndjesisë së frikës së personelit ndaj raportimit të incidenteve.

A ka qenë produktiv projekti, domethënë a janë realizuar pritshmëritë deri më tani?

Fillimisht personeli ka qenë i frikësuar për të raportuar incidentet spitalore dhe ne e prisim këtë gjë. Ne nuk mund të dimë me saktësi se sa incidente kanë ndodhur dhe sa janë raportuar. Por ne jemi të

sigurt që frika kundrejt raportimit të incidenteve spitalore është minimizuar në maksimum. Ajo çka ne synojmë në ditët e para të këtij fillim viti, është realizimi i një përmbledhjeje të incidenteve të raportuara për të parë sesi ka ecur i gjithë procesi, cilat kanë qenë incidentet më të shpeshta, cilat kanë qenë incidentet që kanë rrezikuar më shumë sëmundshmërinë ose cilat kanë qenë ato incidente që mund të rrezikojnë jetën, a janë incidente mjekësore apo jomjekësore etj. I gjithë qëllimi i nismës në fjalë është reduktimi nga viti në vit i incidenteve spitalore, jo të raportuara më pak, por të ndodhura më pak. Kjo është një praktikë e cila është mirë të përhapet në të gjithë Shqipërinë, pasi nuk kërkon kosto dhe informim te veçantë.

Cilat janë përfitimet që sjellin raportimet e incidenteve spitalore?

Përfitimet nga raportimet merren pas një periudhë të caktuar kohore dhe pasi është realizuar një përmbledhje për të parë se cilat kanë qenë incidentet më të shpeshta dhe cilat janë ato incidente

që rrezikojnë më shumë në mënyrë që të dimë si të reagojmë ndaj tyre. Për shembull, mundet që pas një muaji, në qoftë se rezultojnë që janë raportuar disa incidente në infrastrukturë (tela të zhveshura, prishje të rubinetëve etj) në bazë të këtyre raporteve ne bëjmë një inspektim dhe i rregullojmë.

A ka hezituar personeli përse i takon raportimit të incidenteve spitalore?

Nisma ka filluar që vitin e kaluar dhe ende nuk ka mbërritur tek reagimi dhe jo vetëm tek reagimi, por duhet mbërritur tek përmirësimi. Pengesa e fazës së parë ka qenë pikërisht heqja e frikës për të raportuar incidentet, e dyta është analiza dhe reagimi, ndërsa e treta është përfitimi (çfarë përmirësohet me kalimin e kohës).

Në Perëndim, ky proces megjithëse është edhe më voluminoz, funksionon normalisht. Ndërsa tek ne kërkon pak më shumë kohë. Këto janë iniciativa të cilat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, por kjo varet nga vëmendja dhe rëndësia që do t'i kushtojmë.

“

Në Perëndim ky proces megjithëse është edhe më voluminoz, funksionon normalisht. Ndërsa tek ne kërkon pak më shumë kohë. Këto janë iniciativa të cilat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, por kjo varet nga vëmendja dhe rëndësia që do t'i kushtojmë

”

Drejtori Pandi Papando e ka vlerësuar projektin duke theksuar mbështetjen e drejtorisë për punën e nisur por edhe vijimësinë e saj më tej

Drejtori Papando: Projekti po ndërton spitalin me nivele bashkëkohore

"Ne jemi në vazhdim të një projekti të USAID-it për dy probleme. Problemi i parë është ai i mirëmenaxhimit të veprimtarisë së personalit të spitalit dhe disa probleme që lidhen me hyrje-daljen dhe kthimin e një spitali në nivelet bashkëkohore. Kuptohet që ndihma e USAID-it është gjithnjë prioritare në sistemin tonë të shëndetësisë dhe për mua personalisht, sepse këto janë paratë e taksapaguesve amerikanë që janë vënë në dispozicionin tonë për të na mësuar më të mirën.

"Për më tepër ky është një projekt i shtrirë në vetëm

3 spitale në vend dhe do të zbatohet brenda afateve të caktuara. Me marrjen e detyrës unë i dhashë menjëherë rrugë për një zhvillim sa më të shpejtë këtij projekti të USAID-it qoftë për të mbyllur shpejt këtë projekt, qoftë për të krijuar edhe premisat për një bashkëpunim të mëtejshëm edhe në fusha të tjera të mjekësisë. Nga takimet dhe bisedat me personat e USAID-it që ndjekin projektin kemi arritur përfundimin që ta shtyjmë më tej projektin dhe për të krijuar mundësinë e disa modifikimeve në dobi të punës. Cilat janë aspektet pozitive të zbatimit të këtij

projekti?

Sa i takon pjesës për komunikimin e mirë të personelit kjo është në qendër të vëmendjes dhe të Ministrisë së Shëndetësisë qoftë me kodin e etikës, me urdhërin e mjekut dhe infermierit dhe gjithë ato udhëzimet dhe prezantimi që sjell USAID-i për këtë problem, janë të gjitha në përputhje me këtë kod. Problemi kryesor në gjithë sistemin mjekësor është që pacienti është mbret dhe ne shërbëtorët e tij, ndaj secili nga ne duhet të punojë në formë të tillë që gjithmonë t'i krijojmë kushtet më të mira pacientit

dhe familjarëve të tij. Në këtë pikëpamje, ne i dimë kushtet jo të mira të sistemit shëndetësor sa i takon mungesës në medikamente, fondet për të bërë restaurime tërësore ose të pjesshme dhe nga këto kur s'mund të japim atë që duhet, një fjalë e mirë, një mirëkuptim e lehtëson pacientin duke përcjellë imazhin se këtu ka njerëz të përkushtuar. Sa i takon lëvizjes së mjeteve dhe personelit, për mendimin tim me këtë ndërhyrje ky spital do kthehet në spital bashkëkohor, ashtu si spitalet në gjithë vendet e Europës dhe Amerikës ku ne synojmë të shkojmë.



Specialistja e Marrëdhënieve me Publikun flet lidhur me zbatimin e projektit "Në Mbështetje të Reformës në Shëndetësi" dhe të mirat që ai do të sjellë për pacientët e spitalit të Korçës

Guçi: Sportelet dhe kontrolli i vizitave, për një shërbim cilësor

"Në mbështetje të reformës në shëndetësi" është një projekt që mbështetet nga USAID dhe po zbatohet aktualisht edhe në qytetin e Korçës. Stela Guçi, specialiste e Marrëdhënieve me Publikun pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë, për gazetën "Shëndet+" flet lidhur me angazhimin e specialistëve të këtij spitali dhe nevojën e aplikimit të reformave të tilla.

"Spitali i Korçës si shumë prej spitaleve të tjera në Shqipëri nuk ka pasur politika të shkruara për kontrollin e numrit të vizitorëve që lejohen të vizitojnë të sëmurin gjatë së njëjtës periudhë kohe. Gjatë orareve të vizitave, shumë vizitorë mblidhen rreth shtretërve të të sëmurëve, sorollaten përgjatë spitalit, hyjnë në dhomat e mjekimit dhe ndërpresin kujdesin për pacientin.

"Institucionalizimi i një politike të kontrollit të vizitorëve, me hapësirat e duhura të pritjes së vizitorëve dhe një sistem regjistrimi të këtyre vizitorëve, do të zvogëlojë dukshëm lëvizjen e

vizitorëve në spital, do të përmirësojë parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve dhe do të sigurojë privatësinë dhe kushtet e duhura për qetësinë e pacientëve, veçanërisht në dhomat me shumë shtretër", shprehet Guçi.

Më tej ajo vijon se "mënyra se si spitalet e përdorin hapësirën ka impakt mbi kënaqësinë e pacientëve dhe të stafit, duke ndikuar direkt mbi kostot dhe eficiencën spitalore, duke pasur ndikim të rëndësishëm mbi performancën klinike, sepse lidhet ngushtësisht me parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve".

Gjithashtu një ndihmë tepër e madhe pretendohet të jetë rikonstruksioni i recepsioneve. Guçi shpjegon se "duke u nisur nga këto elemente, në spitalin e Korçës në bashkëpunim me projektin "Në Mbështetje të Reformës në Shëndetësi" financuar nga USAID-i u mendua dhe është aktualisht në përfundim rikonstruksioni i tre recepsioneve: recepsionit të Pediatrisë, Hyrjes Kryesore dhe Urgjencës. Pas mobilimit të këtyre ambienteve dhe

vendosjes së sinjalistikës së duhur të brendshme dhe të jashtme, e cila do të ndihmojë orientimin dhe lëvizjen e pacientëve dhe vizitorëve, recepsionet dhe zonat e pritjes në tre pikat e sipërpërmendura do të bëhen plotësisht funksionale. Disa nga detyrat kryesore që do të kryejnë recepsionet do të jenë: pranimi dhe regjistrimi i pacientëve urgjente, regjistrimi i shtrimeve të pacientëve të planifikuar, regjistrimi i ekzaminimeve dhe analizave laboratorike dhe radiogjike, shërbimi i arkës, kontrolli i vizitorëve dhe informimi i pacientëve dhe vizitorëve në lidhje me shërbimet, rregullat dhe politikat e spitalit.

"Në bashkëpunim me projektin, grupet e punës së spitalit dhe konkretisht grupi i Kontrollit të Vizitorëve dhe grupi i Marrëdhënieve me Publikun kanë përgatitur një rregullore për mirëfunksionimin e recepsioneve, e cila përfshin detyrat dhe përgjegjësitë që duhet të ushtrojnë recepsionistët, sikurse janë: regjistrimi i shtrimeve, vizitave, pritja, orientimi dhe informimi i pacientëve dhe vizitorëve, respektimi i privatësisë dhe konfiden-

cialitetit të pacientëve, respektimi i kodit të etikës dhe kodit të sjelljes. Punonjësit e recepsioneve do të trajnohen mbi standardet e kujdesit për klient/pacientin për të siguruar zbatimin e rregullores, por edhe për të rritur kënaqësinë e klientëve/pacientëve që vizitojnë spitalin tonë. Një fushatë informimi e komunitetit të Korçës që do të përfshijë intervista dhe biseda në median lokale, do të kryhet për të sensibiluar qytetarët për funksionimin e recepsioneve të reja, në lidhje me rregullat për lëvizjen e qytetarëve dhe vizitorëve".

Sipas Guçit, "grupet e punës të ngritura nga spitali në bashkëpunim me projektin kanë përgatitur dhe procedurat për monitorimin dhe përfundimin e zbatimit të politikës së kontrollit të vizitorëve. "Ne besojmë se kjo nismë e projektit ka për të rezultuar shumë e suksesshme pas vënies në punë të recepsioneve në përfundim të rikonstruksionit dhe gjithashtu mendojmë që Ministria e Shëndetësisë duhet ta shtrijë këtë model të suksesshëm edhe në spitalet e tjera rajonale në vend", përfundon ajo.



“
Falë projektit “Mbështetje Reformës në Shëndetësi” mbështetur nga USAID-i, në spitalin e Lezhës janë ngritur tre recepsione moderne, të cilat do të realizojnë koordinimin e vizitorëve në mënyrë korrekte. Drejtori i Spitalit të Lezhës, Nevruz Bara, shpjegon detajet e kësaj nisme të re që po ndërmerret në këtë spital

Vizitat, spitali Lezhë ngre sporte të menaxhimit korrekt

Spitali i Lezhës po ecën me ritme të kënaqshme sa i takon rregullit, korrektesisë dhe dhënies së shërbimit të pacientit. Madje, ndryshe nga sa ka ndodhur deri më sot, ku në spitale të afërmit e pacientëve janë futur orar dhe pa orar, tashmë njerëzit do të përbalen me rregulla të reja.

Falë projektit “Mbështetje Reformës në Shëndetësi” mbështetur nga USAID-i, në spitalin e Lezhës janë ngritur tre recepsione moderne, të cilat do të realizojnë koordinimin e vizitorëve në mënyrë korrekte. Drejtori i Spitalit të Lezhës, Nevruz Bara, shpjegon detajet e kësaj nisme të re që po ndërmerret në këtë spital.

Dr. Bara, mund të na thoni konkretisht cili është funksioni këtyre sporteve?

Duhet të theksoj se projekti “Mbështetje Reformës në Shëndetësi”, financuar nga USAID-i, po na ndihmon shumë me idetë e reja që po vendosim në zbatim. Ndër

Drejtori i Lezhës flet lidhur me sportet e reja të ngritura në spitalin rajonal, një risi në sistemin shëndetësor për vizitat e kontrolluar në spitale

to janë edhe sportet, të cilat do të bëjnë të mundur menaxhimin korrekt të vizitorëve dhe të pacientëve. Tashmë kemi ngritur tre sporte: njëri është tek matemiteti, tjetri tek urgjenca dhe i treti tek hyrja kryesore e spitalit. Këto tre sporte do të bëhen tre rregullatorë shumë të mirë, që pritet të sjellin efekte pozitive.

Cilat do të jenë këto efekte pozitive?

Efektet pozitive do të jenë në radhë të parë në dobi të pacientit, në dobi të personelit dhe në dobi të spitalit. Konkretisht nuk do të ketë më fluks vizitorësh pa orar te koka e pacientit, duke i sjellë atij shqetësime dhe duke rritur rrezikun e infeksioneve spitalore.

Personeli do të punojë më i qetë dhe nuk do të ketë vërdallë vizitorë pa kriter, të cilët i bëjnë njëkohësisht 100 pyetje, duke mos i lënë të përqendrohen në punën e tyre dhe duke i vënë nën presion. Spitali do të jetë më efektiv, më i pastër dhe më i rregullt dhe si rezultat do të ulet edhe numri i pacientëve, pasi do të shmanget shumë infeksionet spitalore.

Si do të funksionojnë konkretisht sportet?

Këto sporte do të menaxhohen nga stafi ynë, i cili është i përgatitur për këtë punë. Vizitori do të paraqitet te sporteli, më pas do të pyetet se tek cili pacient kërkon të shkojë. Do të orientohet nga personeli me

udhëzimet përkatëse, të tipit: nuk lejohet duhani, nuk lejohet zhurma në spital dhe do t'i caktohet orari që do të rrijë tek i sëmurit. Më pas vizitori do të lërë tek sporteli kartën e identitetit, e cila i kthehet pasi mbaron vizitën dhe do të pajiset me kartën e vizitorit.

A do të pasohet me ndonjë hap tjetër mbajtja e të dhënave të pacientit?

Po, sigurisht. Po punojmë fort edhe për dixhitalizimin e të dhënave të pacientëve, çka do të thotë që kartelat tradicionale do të zëvendësohen me ato dixhitale. Të dhënat e pacientëve do të jenë në një sistem modern ku personeli mund t'i gjejë të dhënat e tij në kohë rekord dhe brenda gjithë sistemit të spitalit. Pra, është një punë e cila do të lehtësojë bluzat e bardha, por edhe pacientët do t'i kenë këto të dhëna për një kohë të gjatë në sistem. Ende nuk kemi filluar për ndërtimin e këtij rrjeti për shkak të fondeve, por presim që ta realizojmë shumë shpejt.

